




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i biznesit: "Kosovo News Network" SH.A.


Numri Unik Identifikues: 811444124

Pronar: Rizvan REXHAJ

OSHMA: ART

Adresa: Zona Industriale

Prishtinë



VENDIM

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes ART, me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. ART është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA - TV), i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e programeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes. KPM, me datën 27 tetor 2010, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA ART, për një afat të licencës prej dhjetë (10) vitesh.
3. Me datën 27 tetor 2020, ka skaduar afati i licencës për ART, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtëritjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 7 tetor 2020, OSHMA ART ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.

Arsyetimi

5. OSHMA ART, ka parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së duke shfrytëzuar të drejtën e ripërtëritjes së licencës e paraparë me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në.


6. Neni 25 i Ligjit për KPM-në thekson:

“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kriterëve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”.

krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje në pajtim me ligjin për KPM.

Vendim

7. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 13 nëntor 2020, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së OSHMA ART, për të ushtruar veprimtarin si ofrues i shërbimeve mediale audiovizuale, me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
8. Licenca e KPM-së për OSHMA ART do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 27 tetor 2020.
9. Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, të OSHMA ART, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
10. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



13.11.2020

datë